

VENDIM
Nr. 643, datë 5.10.2022

**PËR PËRCAKTIMIN E PËRBËRJES DHE TË MËNYRËS SË FUNKSIONIMIT
TË KOMITETIT PËR PLANIFIKIMIN KOMBËTAR SPITALOR**

(Ndryshuar me VKM nr. 233, datë 1.4.2026)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 6, të ligjit nr. 55/2022, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e përbërjes dhe të mënyrës së funksionimit të Komitetit për Planifikimin Kombëtar Spitalor, si organ këshillimor pranë ministrit përgjegjës për shëndetësinë, me 9 (nëntë) anëtarë, si më poshtë vijon:

- Prof. Alban Dibra, mjek kardiolog;
- Prof. Roland Bani, mjek familjeje;
- Prof. Alketa Qosja, mjek neonatologe;
- Prof. Altin Veshti, mjek kardiokirurg;
- Prof. Arben Rroji, mjek radiolog;
- Prof. Helidon Nina, mjek kirurg onkolog;
- Dr. Leon Kaza, mjek gjinekolog;
- Dr. Skënder Brataj, mjek urgjence;
- Znj. Rudina Degjoni, ekonomiste.

2. Anëtarët e Komitetit për Planifikimin Kombëtar Spitalor zgjidhen për një periudhë 3-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

3. Komiteti për Planifikimin Kombëtar Spitalor, gjatë veprimtarisë së tij, asistohet nga sekretari i këtij komiteti, i cili është një specialist pranë drejtorisë përgjegjëse për politikën dhe menaxhimin e shërbimit spitalor në ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë.

4. Kryetari dhe nënkryetari i komitetit zgjidhen nga anëtarët e këtij komiteti në mbledhjen e parë me shumicë votash.

5. Komiteti për Planifikimin Kombëtar Spitalor mblidhet me kërkesë të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe kryen këto funksione:

- a) Analizon situatën aktuale të shtrirjes së shërbimit spitalor në vend;
- b) Vlerëson nevojat dhe kapacitetet spitalore kombëtare, bazuar në kriteret territoriale, demografike, socioekonomike, barrën e sëmundshmërisë, si edhe në plotësim të kërkesave didaktike dhe shkencore të edukimit mjekësor;
- c) Paraqet për shqyrtim pranë ministrit Planin Kombëtar Spitalor;
- ç) Jep mendime për çështjet e përcaktuara në nenin 6, të ligjit nr. 55/2022, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe për çështje të tjera që lidhen me politikën spitalore të kërkuara nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.

6. Vendimet e komitetit merren me shumicën e të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

7. Vendimi nr. 403, datë 19.6.2004, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe mënyrën e funksionimit të Komitetit Shtetëror për Planifikimin Spitalor”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku